

PROJEKTI KOSOVO SOLAR – TUÇEP DHE VERIQ VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

Plani i angazhimit të palëve të interesit (PAPI)

Shkurt 2026



KLIENTI:	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
PROJEKTI:	Projekti Kosovo Solar – Tuçep dhe Veriq
DOKUMENTI:	Plani i angazhimit të palëve të interesit
PËRGATITUR NGA:	Quant Renewables Kosovo Invest Limited, me mbështetje teknike nga ENOVA
DATA:	Shkurt 2026



PËRMBAJTJA

AKRONIMET DHE SHKURTESAT	5
1 HYRJE.....	6
1.1 Konteksti i Projektit.....	6
1.2 Objektivat dhe fusha e zbatimit të këtij Plani të angazhimit të palëve të interesit	7
1.3 Përgjegjësia për implementimin e këtij Plani të angazhimit të palëve të interesit.....	7
2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	8
2.1 Lokalitetet e Projektit.....	8
2.2 Pasqyrë e komponentëve të Projektit	9
2.3 Statusi i zhvillimit të Projektit.....	10
3 KËRKESAT RREGULLATORE PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT	12
3.1 Kërkesat sipas legjislacionit të brendshëm.....	12
3.2 Kërkesat sipas BERZH/EBRD	14
4 PALËT E INTERESIT TË PROJEKTIT	15
5 ANGAZHIMI I MËPARSHËM I PALËVE TË INTERESIT GJATË PROCESIT TË PAJISJES SË PROJEKTIT ME LEJE	19
6 ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL.....	21
7 PROGRAMI I PLANIFIKUAR PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT	22
7.1 Inkurajimi i pjesëmarrjes së grupeve të cenueshme.....	22
7.2 Shpalesja e dokumenteve të Projektit.....	23
7.3 Konsultimet e planifikuara.....	23
7.4 Informimi i publikut për punët ndërtimore	24
7.5 Konsultimet gjatë operimit dhe mirëmbajtjes.....	24
7.6 Objektivat dhe metodat e angazhimit.....	25
8 MENAXHIMI I ANKESAVE	30
9 MONITORIMI DHE RAPORTIMI	34
10 SHTOJCAT	35
10.1 Shtojca 1: Formulari i ankesave lidhur me Projektin.....	35
10.2 Shtojca 2: Regjistri i ankesave – Shabllon.....	36
10.3 Shtojca 3: Regjistri i brendshëm i angazhimit të palëve të interesit – Shabllon.....	37

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1: Aktivitetet e zhvillimit të Projektit deri më tani	10
Tabela 7-1: Lista e palëve të interesit të identifikuar dhe metodat specifike të komunikimit dhe angazhimit	26

LISTA E FIGURAVE

Figura 2-1: Lokalitetet e Projektit në zonën e Istogut (Burimi: ENOVA)	8
Figura 2-2: Harta e komponentëve të Projektit (Burimi: ENOVA, bazuar në vizatimet e Projektit Kryesor)	9
Figura 5-1: Njoftimet publike gjatë procesit të VNM-së në nivel lokal (nëntor 2022)	19
Figura 5-2: Njoftimi publik për Kushtet Ndërtimore në gazetën online dhe në lokalitetet e IFV-ve (korrik 2024) ..	20



AKRONIMET DHE SHKURTESAT

BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
DhNBGj	Dhuna dhe ngacmimi me bazë gjinore
IFV	Impiant fotovoltaik
KMS	Kërkesë Mjedisore dhe Sociale
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut në Kosovë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NT	Nënstacion transformatori
PAPI	Plani i angazhimit të palëve të interesit
PJT	Përmbledhja jo-teknike
PMS	Politika Mjedisore dhe Sociale
ShQP	Shoqëri me qëllim të posaçëm
VNM	Vlerësimi i ndikimit mjedisor



1 HYRJE

1.1 Konteksti i Projektit

Pasqyrë. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po shqyrton mundësinë e ofrimit të financimit për ndërtimin dhe operimin e dy impianteve fotovoltaike (IFV) të mëdha dhe infrastrukturës shoqëruese në Kosovë, me një kapacitet të kombinuar prej 142.2 MWp (në vijim “Projekti”):

- > IFV Tuçep – kapacitet 98.5 MWp; dhe
- > IFV Veriq – kapacitet 43.7 MWp.

Projekti është kategorizuar si “B” sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale (PMS) të BERZH-it (2024).¹ Një përshkrim më i detajuar i Projektit jepet në kapitullin vijues.

Implementuesi i Projektit. Projekti do të implementohet nga Quant Renewables Kosovo Invest Limited (në vijim “Huamarrësi”), si përfitues i huas nga BERZH, ndërsa fondet do t’u huazohen më tej shoqërive me qëllim të posaçëm (ShQP) të themeluara në Kosovë – AKG Solar Tuçep dhe AKG Solar Veriq, të cilat do të operojnë impiantet fotovoltaike (IFV) përkatëse. Të dy impiantet do të realizohen nëpërmjet një kontrate të vetme me çelësa në dorë (në vijim “turnkey”) me kompaninë SolarApex (në vijim “Kontraktori”). Kompania SolarApex do të jetë përgjegjëse për fazën e ndërtimit si dhe për dy vitet e para të operimit dhe mirëmbajtjes së Projektit.

Përfitimet nga Projekti. Përfitimet potenciale gjatë fazës së ndërtimit të Projektit përfshijnë mundësi të përkohshme punësimi për fuqinë punëtore lokale dhe zhvillimin e aftësive profesionale të saj, si dhe angazhimin e nënkontraktorëve në nivel lokal dhe krijimin e mundësive për bizneset lokale. Përfitimet më të rëndësishme që rrjedhin nga implementimi i Projektit do të materializohen gjatë fazës së operimit, duke përfshirë:

- > Prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, duke kontribuar në prodhimin e energjisë së pastër dhe pa ndotje dhe në reduktimin e varësisë nga lëndët djegëse fosile;
- > Kontribut në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike të Kosovës, përkatësisht në zbutjen e ndryshimeve klimatike përmes reduktimit të emetimeve të gazrave serrë, pasi nevoja për prodhimin e energjisë nga lëndët djegëse fosile do të zvogëlohet;
- > Kontribut në uljen e ndotjes së ajrit duke reduktuar emetimet e ndotësve të ajrit (SO_x, NO_x, PM_{2.5}, PM₁₀) nga termocentralet që përdorin lëndë djegëse fosile, si rezultat i zvogëlimit të nevojës për prodhimin e energjisë nga këto centrale;
- > Rritjen e sigurisë energjetike dhe diversifikimin e burimeve të energjisë përmes rritjes së kapacitetit të brendshëm për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;
- > Mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes promovimit të investimeve në energji të ripërtëritshme;
- > Angazhimin e nënkontraktorëve në nivel lokal dhe krijimin e mundësive të punësimit për komunitetin lokal.

¹ PMS e BERZH-it e vitit 2024 është në dispozicion këtu: <https://www.ebrd.com/home/news-and-events/publications/institutional-documents/environmental-and-social-policy-2024.html>

Kuadri strategjik kombëtar. Projekti përfaqëson një nga investimet më të mëdha në energjinë e ripërtëritshme në Kosovë deri më sot dhe është plotësisht në përputhje me prioritetet e vendit për tranzicionin energjetik.

Kosova është zotuar të implementojë objektivat e Komunitetit të Energjisë, të cilat përfshijnë reduktimin prej 32% të emetimeve neto të gazrave serrë nga sektori i energjisë deri në vitin 2031 dhe sigurimin që të paktën 35% e konsumit të energjisë elektrike të vijë nga burimet e energjisë së ripërtëritshme deri në të njëjtin vit. Këto objektiva pasqyrohen në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022–2031 dhe mbështeten drejtpërdrejt nga ky Projekt.

Për më tepër, Projekti kontribuon në arritjen e objektivave për energjinë e ripërtëritshme dhe dekarbonizimin të përcaktuara në Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025–2030, ku promovimi i energjisë së ripërtëritshme përbën objektivin e dytë strategjik.

Projekti gjithashtu mbështet Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike 2019–2028, e cila synon zbutjen e emetimeve të gazrave serrë dhe forcimin e qëndrueshmërisë klimatike në sektorin e energjisë, përmes rritjes së përdorimit të energjisë së ripërtëritshme dhe reduktimit të varësisë nga qymyri për prodhimin e energjisë elektrike.

1.2 Objektivat dhe fusha e zbatimit të këtij Plani të angazhimit të palëve të interesit

Ky Plan i angazhimit të palëve të interesit (PAPI) është përgatitur nga Huamarrësi me qëllim që t'ua komunikojë qartë të gjitha palëve të interesit dhe palëve të prekura nga Projekti programin e angazhimit të palëve të interesit, i cili do të implementohet gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.

Objektivi është të lehtësohet procesi i marrjes së vendimeve që lidhen me Projektin dhe të krijohen mundësi për përfshirjen aktive dhe me kohë të të gjitha palëve të interesit, si dhe të ofrohen mundësi që këto palë të interesit të shprehin opinionet dhe shqetësimet e tyre, të cilat mund të ndikojnë në vendimet që lidhen me Projektin. Prandaj, qëllimi i këtij PAPI është të forcojë angazhimin e palëve të interesit gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit, si dhe të sigurojë që ky angazhim të zhvillohet në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe me kërkesat e BERZH-it.

Ky PAPI është një dokument dinamik, i cili do të azhurnohet periodikisht, sipas nevojës, për të pasqyruar ndryshimet kryesore në aktivitetet e Projektit ose zhvillimet e reja në fushëveprimin e Projektit.

1.3 Përgjegjësia për implementimin e këtij Plani të angazhimit të palëve të interesit

Huamarrësi, së bashku me ShQP-të, është përgjegjës për implementimin e Projektit. Personi i mëposhtëm është caktuar si person kontakti për të gjitha çështjet që lidhen me këtë PAPI, përfshirë edhe mekanizmin e përgjithshëm të ankesave lidhur me Projektin:

z. Arten Bajrush, AKG SOLAR
E-mail: arten.bajrush@akgsolar.com
Telefoni: +383 49 789 907

Shënim: Ankesat që lidhen me DhNBGj do të trajtohen përmes një kanali të veçantë dhe konfidencial, të udhëhequr nga Pika Fokale e Projektit për DhNBGj (shih kapitullin 8 – MENAXHIMI I ANKESAVE).

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Një përshkrim më i detajuar i punëve të planifikuara është dhënë në **Përmbledhjen jo-teknike** e cila është pjesë e paketës së shpalosjes së informacioneve për publikun nga Projekti, së bashku me këtë Plan të angazhimit të palëve të interesit.

2.1 Lokalitetet e Projektit

IFV-të Tuçep dhe Veriq do të vendosen brenda **Komunës së Istogut**, në Rajonin e Pejës, në pjesën veriperëndimore të Kosovës.

IFV Tuçep do të instalohet në afërsi të **vendbanimeve Kërrninë dhe Tuçep**, ndërsa IFV Veriq do të vendoset në afërsi të **vendbanimeve Veriq dhe Veriq i Ri** (Figura 2-1).




Figura 2-1: Lokalitetet e Projektit në zonën e Istogut (Burimi: ENOVA)

Lokalitetet e IFV-ve janë të përfshira në **Hartën Zonale të Komunës së Istogut** për periudhën 2024–2032.²

² Në dispozicion këtu: <https://istog.rks-gov.net/harta-zonale-komunale-2024-2032/>

2.2 Pasqyrë e komponentëve të Projektit

Siç është përcaktuar në Projektet Kryesore të finalizuara në vitin 2025, përveç IFV-ve, në kuadër të Projektit parashikohen katër **nënstacione transformimi (NT)** që do të ndërtohet si vijon:

- > dy nënstacione të brendshme 10/33 kV në lokalitetin Tuçep;
- > një nënstacion i brendshëm 10/33 kV në lokalitetin Veriq; dhe
- > një nënstacion 33/110 kV, i ashtuquajtur nënstationi Kërrninë 2.

Tri nënstationet e brendshme³ 10/33 kV do të lidhen me nënstationin 33/110 kV Kërrninë 2, ndërsa nënstationi Kërrninë 2 do të lidhet me nënstationin ekzistues 110/400 kV Pejë 3, me qëllim të sigurimit të lidhjes me rrjetin energjetik. Të gjitha lidhjet ndërmjet nënstationeve do të realizohen përmes kablove nëntokësore.

Në secilin lokalitet të IFV-ve do të ndërtohet gjithashtu një **objekt administrativ dhe depo**, për të mbështetur funksionet e përditshme operative dhe të sigurisë së impiantit. Këto objekte do të shërbejnë si pika kontrolli dhe monitorimi për aktivitetet në lokalitet, duke akomoduar personelin e sigurisë dhe të mirëmbajtjes, si dhe duke ofruar hapësirë për ruajtjen e pajisjeve operative, pjesëve rezervë dhe mjeteve të mirëmbajtjes.

Një përmbledhje e infrastrukturës së përshkruar është dhënë në figurën më poshtë.




Figura 2-2: Harta e komponentëve të Projektit (Burimi: ENOVA, bazuar në vizatimet e Projektit Kryesor)

³ Nënstationet e brendshme janë të dedikuara për një IFV të caktuar dhe kanë për qëllim të shërbejnë ekskluzivisht për transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga ai impiant.

Të dy lokalitetet janë të qasshme përmes infrastrukturës ekzistuese të rrjetit rrugor. Përveç kësaj, si pjesë e Projektit, do të ndërtohen **rrugë të brendshme për qasje** brenda parcelave të IFV-ve.

2.3 Statusi i zhvillimit të Projektit

Projekti ka avancuar përmes disa hapave të rëndësishëm përgatitorë, kryesisht në aspektin e lejeve dhe projektimit. Një përmbledhje e aktiviteteve të implementuara deri më tani është dhënë në tabelën më poshtë.

Tabela 2-1: Aktivitetet e zhvillimit të Projektit deri më tani

FAZA	PËRSHKRIMI
VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR (VNM) DHE LEJET MJEDISORE	<p>Në përputhje me <i>Ligjin për VNM</i> në Kosovë, Projekti hyn në kategorinë e projekteve për të cilat nevoja një VNM i plotë që përcaktohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), bazuar në kriteret specifike të shqyrtimit të përcaktuara nga ky ligj. MMPHI ka përcaktuar se është e nevojshme të kryhet VNM-ja; së këndejmi, në vitin 2022 janë përgatitur Raportet e VNM-së për secilin IFV.</p> <p>Në dhjetor 2022 janë mbajtur takime publike për shpalesjen e informacioneve për të prezantuar gjetjet dhe përfundimet e raporteve të VNM-së.</p> <p>Pas miratimit të raporteve të VNM-së dhe zhvillimit të takimeve publike për shpalesje të informacioneve, MMPHI ka nxjerrë Vendimet për Pëlqim Mjedisor për të dy IFV-të në janar 2023. Gjatë periudhës dyvjeçare të vlefshmërisë së këtyre pëlqimeve mjedisore, ShQP-të kishin për detyrim të siguronin miratimet e radhës sipas zbatueshmërisë, përkatësisht Kushtet Ndërtimore (për detaje shih seksionin “Miratimet për Ndërtim” më poshtë).</p> <p>Pas përfundimit të ndërtimit dhe para fillimit të operimit, për secilin IFV duhet të merret Leja Mjedisore, e cila konfirmon përputhshmërinë e punimeve me Vendimin për Pëlqim Mjedisor të lëshuar. Leja Mjedisore është e vlefshme për pesë vjet.</p>
DOKUMENTACIONI TEKNIK	<p>Në vitin 2022 është përgatitur një Raport Gjeoteknik, i cili vlerëson kushtet gjeologjike dhe inxhinierike të zonës së Projektit dhe shërben si bazë për projektimin e themeleve dhe kërkesat specifike të ndërtimit në lokalitet.</p> <p>Projektet Kryesore për secilin IFV, që përfshijnë aspektet arkitekturore, strukturore, elektrike, hidroteknike, mekanike dhe të mbrojtjes nga zjarri, janë finalizuar në mars 2024.</p> <p>Përveç kësaj, në tetor 2025 janë kryer Ilogaritjet përfundimtare të prodhimit të energjisë për IFV-të duke përdorur softuerin PVsyst.</p>
MARRËVESHJA E QIRASË PËR TOKËN	<p>Të dy ShQP-të kanë lidhur marrëveshje të veçanta për qira afatgjatë të tokës me kompaninë “Gekos”, e cila ka marrë nga shteti tokën me qira për 99 vjet, me të drejtë për dhënie me qira palëve të treta. Marrëveshjet përfshijnë dhënie me qira palëve të treta për 80 vjet për IFV Tuçep (e nënshkruar në dhjetor 2023) dhe dhënie me qira palëve të treta për 78 vjet për IFV Veriq (e nënshkruar në janar 2024).</p>
MIRATIMET QË LIDHEN ME NDËRTIMIN	<p>Në shkurt 2024, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka dhënë miratim për ndryshimin e përkohshëm të destinimit të tokës për lokalitetin e IFV Tuçep, duke lejuar konvertimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për</p>

FAZA	PËRSHKRIMI
	<p>qëllimin e ndërtimit të një parku solar.⁴</p> <p>Më pas, në gusht 2024, MMPHI ka lëshuar Kushtet Ndërtimore për të dy IFV-të. Këto kushte përcaktojnë situacionin dhe kërkesat teknike për IFV-të dhe infrastrukturën shoqëruese, përfshirë rrugët e brendshme, NT, objektin administrativ dhe depon, rrethojnë e sigurisë, etj. Kushtet Ndërtimore janë të vlefshme për dy vjet dhe shërbejnë si parakusht për marrjen e Lejes Ndërtimore.</p> <p>Lejet Ndërtimore për të dy lokalitetet janë marrë në janar 2026.</p> <p>Pas përfundimit të ndërtimit, ShQP-të do të duhet të sigurojnë Certifikatën e Shfrytëzimit për secilin IFV, e cila lëshohet nga MMPHI.</p>
MARRËVESHJET PËR KYÇJE	<p>Në dhjetor 2024, janë nënshkruar Marrëveshjet për Kyçje me Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) për të dy IFV-të. Këto marrëveshje përcaktojnë kushtet kryesore të kyçjes në sistemin transmetues, përfshirë: pikën e kyçjes, nivelin e tensionit, kapacitetet, dhe përgjegjësitë përkatëse të palëve. Kjo i mundëson Projektit të sigurojë formalisht qasjen në rrjetin energjetik. Specifikimet teknike përfundimtare për asetet e transmisionit (NT i ri, kabloja nëntokësore 110 kV, dhe kyçja brenda NT Pejë 3) aktualisht janë duke u përgatitur nga KOSTT dhe pritet të finalizohen deri në fund të nëntorit 2025.</p> <p>Pas përfundimit të ndërtimit, për të dy IFV-të do të duhet të merret Licenca për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).</p>

⁴ Ky miratim është dhënë për një sipërfaqe prej 16 hektarësh, e cila nuk ishte e përcaktuar si park solar në Hartën Zonale Komunale. Pjesa tjetër e tokës ishte e përcaktuar si park solar në këtë hartë.

3 KËRKESAT RREGULLATORE PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT

3.1 Kërkesat sipas legjislacionit të brendshëm

Ligjet e Kosovës që rregullojnë shpалosjen e informacioneve dhe konsultimet publike, të cilat janë relevante për këtë Projekt, parashikojnë sa vijon:

- > *Kushtetuta e Republikës së Kosovës* përcakton se dokumentet e autoriteteve shtetërore duhet të jenë të qasshme për publikun, me përjashtim të rasteve që lidhen me mbrojtjen e privatësisë, sekretet tregtare ose arsytet e sigurisë. Gjithashtu, ajo thekson përgjegjësinë kolektive për mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar që opinionet e publikut të dëgjohen dhe të merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve që ndikojnë në mjedis. Në kontekstin e këtij Projekti, parimet kushtetuese për qasjen në informacion, përgjegjësinë mjedisore dhe pjesëmarrjen e publikut aplikohen përmes shpалosjes transparente të informacionit për Projektin dhe marrjes sistematike në konsideratë të qëndrimeve të publikut gjatë proceseve të planifikimit hapësinor dhe marrjes së vendimeve mjedisore.
- > *Ligji nr. 06/L-081 për qasjen në dokumente publike* garanton të drejtën e secilit person për të pasur qasje në dokumente publike. Institucionet publike detyrohen të publikojnë në mënyrë proaktive çdo dokument publik të prodhuar, të pranuar, të mbajtur apo të kontrolluar, në formë elektronike, përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të institucioneve publike, pavarësisht kërkesës së personit për qasje. Publikimi bëhet në formë elektronike, të shtypur, përmes transmetimit, apo në çfarëdo forme tjetër, e cila mundëson qasjen e numrit sa më të madh të publikut. Në kontekstin e këtij Projekti, institucionet përgjegjëse (Komuna e Istogut dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) kanë përbushur plotësisht kërkesat e këtij ligji, duke informuar publikun dhe palët e prekura dhe palët e interesit përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, si faqe zyrtare në internet, radio lokale, njoftime publike, etj., me qëllim që të sigurohet pjesëmarrja e të gjithëve në proces, informimi i tyre dhe mundësia për të shprehur shqetësimet dhe interesat e tyre.
- > *Ligji nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit* dhe *Ligji nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit mjedisor* përcaktojnë detyrimin e institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe të të gjitha organizatave të tjera të autorizuar, për të informuar publikun në mënyrë të rregullt, me kohë dhe objektive. Këto detyrime janë respektuar edhe në kontekstin e këtij Projekti, ku Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka zhvilluar procesin e shqyrtimit dhe ka informuar publikun gjatë procesit të VNM-së.
- > *Ligji nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor* përmban dispozita për pjesëmarrjen e detyrueshme të publikut dhe shqyrtimin publik gjatë miratimit të planeve hapësinore, si dhe kërkesa për lëshimin e Kushteve Ndërtimore. Udhëzimi Administrativ (MMPH) nr. 05/2014 ofron udhëzime shtesë mbi parimet dhe procedurat e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin hapësinor. Këto kërkesa janë aplikuar në mënyrë të rregullt gjatë miratimit të planeve hapësinore të Komunës së Istogut dhe Hartës Zonale Komunale përkatëse. Në përputhje me ligjin, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si autoritet qendror mbikëqyrës, nuk miraton dokumente të planifikimit hapësinor nëse të gjitha procedurat ligjore të konsultimit publik nuk janë implementuar dhe dokumentuar plotësisht. Megjithëse proceset e planifikimit hapësinor dhe zonimit nuk janë pjesë e drejtpërdrejtë e Projektit, ato konsiderohen veprime paraprake relevante, të cilat i kanë paraprirë dhe e kanë mundësuar realizimin e Projektit.

- > *Udhëzimi Administrativ (MPL) nr. 03/2020 për transparencë në komuna* kërkon që organet komunale të publikojnë rregulloret, vendimet dhe dokumentet e nxjerra nga organet komunale që janë në interes të qytetarëve dhe palëve të interesit, si dhe të sigurojnë që të gjitha këto informacione të jenë të qasshme për publikun. Në kontekstin e këtij Projekti, Komuna e Istogut ka mbajtur procesverbalet e konsultimeve publike nga proceset komunale të planifikimit hapësinor, të cilat janë të qasshme për të gjitha palët e interesit.
- > *Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve* rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera publike. Ky ligj i jep status të barabartë gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, si dhe të drejta të barabarta për përdorimin e tyre në të gjitha institucionet. Të gjitha komunitetet kanë të drejtë të ruajnë, mbajnë dhe promovojnë identitetin e tyre gjuhësor. Këto kërkesa do të respektohen në kontekstin e këtij Projekti duke siguruar që paketa e shpalosjes së informacioneve për Projektin të jetë e disponueshme si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën serbe (shih kapitullin 7.1- Shpalosja e dokumenteve të Projektit).
- > *Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale* përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Me këtë ligj përcaktohen përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike. Në kontekstin e këtij Projekti, mjetet dhe shabllonet për mbajtjen e të dhënave në këtë PAPI pasqyrojnë në mënyrë të qartë kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale në Kosovë. Në mënyrë specifike, Shtojca 2 (Regjistri i ankesave) përfshin shënimin: “Çdo e dhënë personale do të përpunohet në përputhje me Ligjin e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndërsa Shtojca 3 (Regjistri i Brendshëm i Angazhimit të Palëve të Interesit) përfshin të njëjtin shënim. Këto shabllone do të përdoren në mënyrë të vazhdueshme për evidentimin e ankesave dhe dokumentimin e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit, duke siguruar që çdo informacion personal i mbledhur të trajtohet në mënyrë të ligjshme, të mbahet konfidencial dhe të publikohet vetëm në formë të anonimizuar ose të agreguar në raportimet publike, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-215. Përveç kësaj, të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë hartimit të këtij PAPI, për të mbështetur aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit, janë mbledhur dhe përpunuar në përputhje me këtë ligj. Të gjithë personave të intervistuar ose u është kërkuar të japin pëlqimin në bazë të informimit paraprak (p.sh., përmes nënshkrimit të një formulari të pëlqimit) për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të tyre personale, ose të dhënat e tyre personale nuk janë mbledhur.
- > Legjislacioni tjetër relevant që siguron kryerjen e konsultimeve të duhura dhe trajtim të barabartë përfshin: *Ligjin nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi*; *Ligjin nr. 04/L-110 për ndërtim*; *Ligjin nr. 05/L-020 për barazi gjinore*; dhe *Ligjin nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë*. Në kontekstin e këtij Projekti, parimet dhe kërkesat e këtyre ligjeve aplikohen duke siguruar: angazhim jo-diskriminues dhe përfshirës të palëve të interesit, qasje të barabartë në informacion dhe në proceset e konsultimit, pjesëmarrje të përgjegjshme gjinore, dhe respektimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.

3.2 Kërkesat sipas BERZH/EBRD

Në PMS të vitit 2024, BERZH ka përkufizuar një grup gjithëpërfshirës të Kërkesave Mjedisore dhe Sociale (KMS) që pritet t'i përmbushin projektet. KP 10 (Shpalosja e informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit) thekson rëndësinë e angazhimit të hapur, domethënës dhe transparent me palët e interesit.

Kërkesat e BERZH-it sipas KMS 10 mund të përmbliidhen si më poshtë:

- > Procesi i angazhimit të palëve të interesit përfshin **identifikimin dhe analizën e palëve të interesit**, planifikimin e angazhimit, shpalosjen e informacionit, konsultimin domethënës, implementimin e një mekanizmi ankesash dhe raportimin e vazhdueshëm të palët përkatëse të interesit. Angazhimi i palëve të interesit duhet të fillojë herët gjatë fazës së zhvillimit të Projektit dhe të vazhdojë gjatë të gjithë ciklit të jetës së tij.
- > Klienti duhet të sigurojë që palët e interesit të kenë **qasje në informacion të kohës, relevant dhe të kuptueshëm**, si dhe që angazhimi të realizohet në mënyrë përfshirëse dhe të përshtatshme për kontekstin kulturor, pa manipulim apo shtrëngim. Klienti do të japë informacione përkatëse shpjeguese lidhur me Projektin, në gjuhën apo gjuhët që përdoren nga komunitetet vendore dhe në një formë që është e qasshme dhe e përshtatshme për kontekstin kulturor, duke marrë parasysh çdo nevojë të veçantë të grupeve që mund të preken në mënyrë diferenciale ose disproporcionale nga Projekti, si dhe të atyre grupeve të popullsisë që kanë nevoja të veçanta për informim. Gjatë gjithë ciklit të jetës së Projektit, klienti do të vazhdojë të ofrojë informacione për palët e interesit të identifikuar në mënyrë të vazhdueshme.
- > Klienti do të realizojë **konsultime domethënëse**, bazuar në natyrën dhe shkallën e rreziqeve dhe ndikimeve negative të Projektit, si dhe në nivelin e interesimit të palëve të interesit.
- > Për të adresuar me kohë shqetësimet e palëve të interesit lidhur me Projektin, klienti do të krijojë një **mekanizëm efektiv të ankesave** sa më herët që të jetë e mundur gjatë fazës së zhvillimit të Projektit, për të pranuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit.
- > Klientëve u kërkohet **të hartojnë dhe të implementojnë një PAPI**, i cili përshkruan mënyrën e realizimit të angazhimit, përfshirë oraret dhe metodat e angazhimit, informacionin që do të shpaloset, gjuhët në të cilat do të shpërndahet informacioni, si dhe llojin e informacionit që synohet të merret nga palët e interesit. Klienti do të identifikojë palët e prekura nga Projekti të cilat, për shkak të rrethanave të veçanta, mund të jenë në pozitë të pafavorshme apo të cenueshme.

4 PALËT E INTERESIT TË PROJEKTIT

Janë identifikuar palët e interesit të Projektit me qëllim përmbushjen e kërkesave të ndryshme për konsultim. Palët e interesit janë kategorizuar në dy kategori kryesore:

- a) **Palë interesi primare;** individë dhe grupe që ndikohen drejtpërdrejt nga Projektin; dhe
- b) **Palë interesi sekondare;** palë që mund të kenë ndikim mbi Projektin, por që jo patjetër preken drejtpërdrejt nga ai, si dhe ato që mund të ndikohen në mënyrë të tërthortë nga Projektin.

Në këtë PAPI, palët e interesit primare përfshijnë komunitetet/ekonomitë familjare/bizneset e prekura nga Projektin, shfrytëzuesit jo-formalë të tokës dhe banorët që mund të ndikohen potencialisht nga reflektimi dhe shkëlqimi i dritës nga modulet fotovoltaike (dukuria e njohur si "glint and glare"), si dhe Huamarrësin/ShQP-të/ekipin e menaxhimit të Projektit dhe fuqinë punëtore të Projektit. Palët e interesit sekondare përfshijnë autoritetet, institucionet dhe organizatat të tjera (p.sh. media dhe OJQ) që mund të kenë interes në Projekt ose ndikim mbi të.

Krijimi i **hartës së palëve të interesit** është realizuar gjatë zhvillimit të këtij PAPI, bazuar në:

- > vizitat në lokalitetin e Projektit dhe diskutimet me banorët lokalë;
- > diskutimet me drejtorin e Drejtorisë Komunale për Planifikim Urban, një anëtar të Kuvendit Komunal dhe dy përfaqësues të fshatrave (Veriq dhe Kërrninë); dhe
- > shqyrtimin e dokumentacionit të disponueshëm të Projektit dhe kërkimin në media.

Palët kryesore të interesit të identifikuar për Projektin janë renditur më poshtë, ndërsa interesat/shqetësimet e tyre specifike dhe metodat e planifikuara të komunikimit jepen në kapitullin vijues. Duhet theksuar se çdo palë interesi që nuk është identifikuar në këtë fazë të projektit mund të kontaktojë drejtpërdrejt personin e përcaktuar në [seksionin 1.2 Objektivat dhe fusha e zbatimit të këtij Plani](#) të angazhimit të palëve të interesit për të bërë të njohur identitetin dhe për të bërë të ditura nevojat e veta, si dhe për të lehtësuar implementimin efektiv të PAPI.

- 1) **Komunitetet lokale (ekonomitë familjare dhe bizneset) që mund të ndikohen nga ndërtimi dhe operimi i IFV-ve (palë interesi primare)**

Lokaliteti i IFV Tuçep ndodhet ndodhet mbi vendbanimet Kërrninë (50–400 m) dhe Tuçep (300 m). Rruga R-221 kalon ndërmjet lokalitetit të IFV-së dhe këtyre vendbanimeve, duke i ndarë ato në mënyrë efektive. Në afërsi të lokalitetit ndodhen 6–7 shtëpi (rreth 50 m në jug), ndërsa zona më e gjerë është me dendësi të rrallë banimi.

Lokaliteti i IFV Veriq ndodhet pranë vendbanimeve *Veriq* dhe *Veriq i Ri*, të cilat lidhen me një rrugë lokale (e quajtur Shaban Hajzeraj). Brenda vendbanimit Veriq i Ri ndodhen 5–6 shtëpi në distanca prej 10 deri në 60 m nga IFV Veriq. Në vendbanimin *Veriq*, rreth 50 shtëpi ndodhen në distancë prej 50 deri në 800 m nga zona e IFV-së.

Përveç kësaj, në Veriq janë identifikuar edhe bizneset në vijim:

- > Dy ferma të vendosura rreth 200–300 m nga IFV Veriq, pas kodrës dhe në një lartësi më të ulët. Të dy fermat përdorin rrugën lokale që do të përdoret gjithashtu për trafikun e ndërtimit.

- > Një kompani që operon me makineritë rëndë, e cila operon me ekskavatorë, buldozerë dhe kamionë për punime të përgatitjes së tokës, dhe që përdor të njëjtën rrugë hyrëse të planifikuar për transportin e materialeve të ndërtimit.
- > Një dyqan ushqimor, i vendosur në hyrje të Veriqit, drejtpërdrejt përgjatë rrugës që do të përdoret për transportin e materialeve të ndërtimit.

Ndërtimi mund të gjenerojë rreziqe të përkohshme për komunitetet lokale në vendbanimet Tuçep, Kërrninë, Veriq dhe Veriq i Ri, duke përfshirë:

- > Emetimet e pluhurit nga punimet tokësore, gërmimet, rindërtimi i rrugëve dhe lëvizja e makinerive mund të ndikojnë te banorët dhe shtëpitë, veçanërisht ato të vendosura brenda 130 m nga zona e Projektit.
- > Zhurma që do të gjenerohet nga transporti, punët ndërtimore, operimi i makinerive dhe përdorimi i pajisjeve të ndërtimit. Nivelet e rritura të zhurmës mund të jenë më të theksuara në IFV Veriq, pasi shtëpitë më të afërta ndodhen rreth 10 m larg, ndërsa zhurmë pritjet edhe në lokalitetin IFV Tuçep, ku shtëpitë më të afërta ndodhen rreth 50 m larg. Megjithatë, ndikimi i përgjithshëm vlerësohet si i ulët për të dy lokalitetet e IFV-ve. Operimi i rregullt i IFV-ve nuk do të gjenerojë emetime të zhurmës.
- > Dridhjet e krijuara gjatë ankorimit mund të përhapen deri në 2 km, por intensiteti i tyre pritjet të mbetet i ulët dhe nuk ka gjasa të shkaktojë shqetësim apo dëme për banorët ose strukturat përreth.
- > Trafiku i lidhur me ndërtimin në rrugët ekzistuese kryesore (R-101 dhe R-221), dhe veçanërisht në rrugën lokale Shaban Hajzeraj (Veriq) dhe rrugën lokale Drenica (Tuçep), mund të shkaktojë degradim të rrugëve, aksidente dhe rritje të rreziqeve të sigurisë për këmbësorët dhe bagëtinë.
- > Ekziston rrezik aksidentesh nëse nuk implementohen siç duhet rrethimi, sinjalizimi dhe kufizimet e qasjes; fermerët dhe barinjët në afërsi mund të ekspozohen ndaj rreziqeve për shkak të afërsisë së parcelave bujqësore dhe zonave të kullotës.
- > Grupet e ndjeshme, si fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe individët me probleme shëndetësore paraprake, mund të jenë veçanërisht të cenueshëm ndaj ndikimeve nga pluhuri, zhurma dhe trafiku i shtuar gjatë ndërtimit. Po ashtu, personat me mobilitet të kufizuar, me aftësi të kufizuara ose me qasje të kufizuara në kanalet kryesore të komunikimit të Projektit (p.sh. transport i kufizuar, qasje e kufizuar në internet ose pengesa në shkrim–lexim) mund të përballen me sfida shtesë në marrjen me kohë të informacionit dhe në paraqitjen e ankesave.

2) Shfrytëzuesit jo-formalë të tokës (palë interesi primare)

Ky grup i palëve të interesit përfshin individë dhe ekonomi familjare që kanë përdorur pjesë të tokës së Projektit për qëllime bujqësore në mënyrë joformale, pa të drejta formale pronësie ose shfrytëzimi. Këta shfrytëzues e kanë kultivuar tokën për periudha të gjata, kryesisht për prodhimin e kulturave bujqësore, dhe në shkallë të ndryshme mbështeten në të si pjesë e mjeteve të jetesës së ekonomisë familjare.

Megjithëse shfrytëzuesit jo-formalë të tokës nuk gëzojnë të drejta ligjore mbi tokën, përdorimi afatgjatë i kësaj zone nënkupton se aktivitetet e Projektit mund të rezultojnë në zhvendosje ekonomike të pjesshme, për shkak të humbjes së qasjes në parcelat e kultivuara. Për këtë arsye, shfrytëzuesit jo-formalë të tokës konsiderohen palë të prekura nga Projekti për qëllimet e këtij plani të angazhimit të palëve të interesit.

Shfrytëzuesit jo-formalë të tokës të identifikuar janë konsultuar si pjesë e procesit të vlerësimit mjedisor dhe social. Angazhimi me këtë grup do të vazhdojë gjatë gjithë implementimit të Projektit,

me fokus në: shpalosjen me kohë të informacionit lidhur me orarin e ndërtimit dhe kufizimet e qasjes në tokë; qasjen në mekanizmin e ankesave të Projektit; dhe komunikimin e masave përkatëse të zbutjes që lidhen me rivendosjen e mjeteve të jetesës.

3) Banorët që mund të ndikohen nga dukuria “glint and glare” apo reflektimi dhe shkëlqimi i dritës nga modulet fotovoltaike (palë interesi primare)

Gjatë përgatitjes së Projektit është kryer modelimi për dukurinë “glint and glare” apo reflektimin dhe shkëlqimin e dritës nga modulet fotovoltaike. Është përcaktuar se deri në pesë prona, që ndodhen në terren të ngritur rreth 750 m në jug-lindje të IFV Tuçep, në fshatin Kërrninë, mund të kenë pamje të drejtpërdrejtë të moduleve fotovoltaike. Përveç kësaj, në vendbanimin Veriq i Ri ndodhen deri në dhjetë prona në distancë të afërt (deri në 150 m në perëndim) nga IFV Veriq, ku ndikimi i mundshëm nga reflektimi dhe shkëlqimi i dritës nuk mund të përjashtohet. Rreth shumicës së këtyre pronave ka breza mbrojtës me bimësi në formën e shkurreve dhe pemëve, ndërsa disa prej tyre janë të rrethuara nga ky lloj bimësie. Kjo mund të kufizojë ndikimin e mundshëm. Rreziku i reflektimit dhe shkëlqimit të dritës për pronat në vendbanimin Veriq i Ri do të eliminohet nëse implementohet mbjellja e brezave mbrojtës me bimësi.

Për këtë arsye, do të vendoset një procedurë për trajtimin e ankesave që lidhen me reflektimin dhe shkëlqimin e dritës, të paraqitura nga pronarët ose shfrytëzuesit e pronave të prekura. Nëse konfirmohet ekzistenca e kësaj dukurie, do të implementohen masa zbutëse në konsultim me banorët e prekur. Këto masa mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: instalimin e strukturave mbrojtëse (p.sh. perde ose roleta për dritare), mbjelljen e brezave mbrojtës me bimësi përpara shtëpive, etj.

4) Palët me interes të përgjithshëm në energjinë e ripërtëritshme dhe/ose projektet e energjisë diellore (palë interesi sekondare)

Kjo kategori përfshin një spektër më të gjerë individësh dhe organizatash të cilat, ndonëse nuk preken drejtpërdrejt nga Projekti, mund të kenë interes në rezultatet e tij. Këtu përfshihen:

- > **Mediat:** Mediat lokale dhe kombëtare luajnë një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacionit për Projektin, në formësimin e opinionit publik dhe në informimin e vazhdueshëm të publikut për zhvillimet e Projektit, përfitimet e tij dhe çdo shqetësim të mundshëm.
- > **Popullata e përgjithshme** e rajonit apo e vendit: Popullata më e gjerë pritet të shfaqë interes për përfitimet që sjell Projekti.
- > **OJQ-të mjedisore:** OJQ-të, veçanërisht ato që fokusohen në energjinë e ripërtëritshme dhe qëndrueshmërinë mjedisore, mund të jenë të interesuara për Projektin. Edhe pse organizata të tilla nuk kanë shprehur ende interes specifik për këtë Projekt, atyre do t’u ofrohen mundësi për të shprehur opinionet ose shqetësimet e tyre gjatë gjithë fazave të përgatitjes dhe implementimit të Projektit. Çdo organizatë e interesuar për Projektin mund të dërgojë të dhënat e kontaktit, në mënyrë që të përfshihet në këtë PAPI dhe të njoftohet drejtpërdrejt për aktivitetet dhe zhvillimet që lidhen me Projektin.

5) Autoritetet relevante qeveritare (palë interesi sekondare)

Ky grup përfshin organe rregullatore dhe institucione me kompetenca mbikëqyrëse dhe interes në përfundimin dhe operimin e suksesshëm të Projektit:

- > **Komuna e Istogut** (përgjegjëse për planifikimin hapësinor në nivel komunal)

- > Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – MMPHI (ka përcaktuar tashmë se për Projektin nevojitet Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (VNM), ka miratuar raportet e VNM-së dhe ka lëshuar Vendimet për Pëlqim Mjedisor për të dyja IFV-të në janar 2023; është përgjegjëse për lëshimin e Lejes Mjedisore pas përfundimit të ndërtimit dhe para fillimit të operimit; MMPHI gjithashtu ka lëshuar Kushtet Ndërtimore për të dy IFV-të për të përkufizuar situacionin dhe kërkesat teknike për IFV-të dhe infrastrukturën përcjellëse).
- > Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës – KOSTT (ka nënshkruar Marrëveshjet e Kyçjes në dhjetor 2024 për të përcaktuar kushtet kryesore të kyçjes në rrjet, gjë që i mundëson Projektit të sigurojë formalisht qasje në rrjet; aktualisht është duke përgatitur specifikimet përfundimtare teknike për asetet e transmisionit, përfshirë NT-në e ri, kabllon nëntokësore 110 kV dhe lidhjen brenda NT Pejë 3).
- > Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE (përgjegjëse për lëshimin e Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike pas përfundimit të ndërtimit).

6) Huamarrësi / ShQP-të / Ekipi i menaxhimit të Projektit (palë interesi primare)

Ky grup i palëve të interesit përfshin Huamarrësin, shoqëritë me qëllim të posaçëm (ShQP), si dhe ekipin e menaxhimit të Projektit përgjegjës për implementimin e përgjithshëm të Projektit. Këta aktorë të brendshëm luajnë rol qendror në sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat përkatëse sipas kuadrit kombëtar dhe me standardet e BERZH-it, duke përfshirë implementimin e këtij PAPI. Përgjegjësitë kryesore në kuadër të këtij PAPI përfshijnë: koordinimin e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit; sigurimin e shpalosjes së informacionit me kohë; mirëmbajtjen dhe monitorimin e mekanizmit të ankesave të Projektit; mbikëqyrjen e performancës së kontraktorit (duke përfshirë implementimin e masave të PMMS që lidhen me shëndetin dhe sigurinë e komunitetit dhe ndikimet shqetësuese); mbajtjen e të dhënave dhe evidencave dhe raportimin tek autoritetet përkatëse dhe te BERZH-i.

7) Punëtorët e SolarApex (Kontraktori) (palë interesi primare)

Punëtorët e Kontraktorit përbëjnë një palë të rëndësishme interesi për realizimin dhe dorëzimin me sukses të Projektit, duke siguruar respektimin e kërkesave të sigurisë dhe përputhshmërinë gjatë procesit të ndërtimit.

5 ANGAZHIMI I MËPARSHËM I PALËVE TË INTERESIT GJATË PROCESIT TË PAJISJES SË PROJEKTIT ME LEJE

Aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit të realizuara deri më tani për të dy IFV-të janë implementuar në përputhje me kërkesat ligjore në Kosovë, në bashkëpunim me MMPHI-në dhe Komunën e Istogut.

- 1) Shpалosja e informacioneve dhe konsultimet gjatë procesit të VNM-së në nivel lokal në nëntor 2022, është publikuar një njoftim publik për të ftuar të gjitha palët e interesit që të shqyrtojnë Raportin e VNM-së (i qasshëm përmes një linku online) dhe të marrin pjesë në një takim publik konsultues për të dy IFV-të. Takimi u mbajt në dhjetor 2022, në Gurakoc, Komuna e Istogut, ndërsa ishte ofruar edhe qasje virtuale përmes platformës Zoom. Në takim morën pjesë përfaqësues të MMPHI-së dhe të Komunës së Istogut. Pavarësisht njoftimeve paraprake në tabelën e njoftimeve të komunës dhe përmes gazetës online “Zëri”, në këto sesione nuk pati pjesëmarrje nga qytetarët apo palët e tjera të interesit. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, miratimet e VNM-së për të dy IFV-të u lëshuan në janar 2023.




Figura 5-1: Njoftimet publike gjatë procesit të VNM-së në nivel lokal (nëntor 2022)

- 2) Shpалosja e informacioneve dhe konsultimet gjatë procesit të lëshimit të Kushteve Ndërtimore MMPHI ka publikuar një njoftim publik në korrik 2024 dhe ka informuar publikun e gjerë për mundësinë e paraqitjes së komenteve (shih figurat më poshtë).

Përveç kësaj, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/19, MMPHI ka organizuar një mbledhje të Komisionit për prezantimin e Projektit para palëve institucionale të interesit. Komisioni ka përfshirë përfaqësues nga: MMPHI, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Bujqësisë, KOSTT, ZRRE dhe Komuna e Istogut. Komisioni nuk ka ngritur asnjë kundërshtim.

Pas përfundimit të këtyre hapave, Kushtet Ndërtimore për të dy IFV-të janë lëshuar në gusht 2024.



Figura 5-2: Njoftimi publik për Kushtet Ndërtimore në gazetën online dhe në lokalitetet e IFV-ve (korrik 2024)

3) Shpalosja e informacionit dhe konsultimet gjatë procesit të planifikimit hapësinor komunal: Gjatë përgatitjes së Hartës Zonale Komunale (2024–2032), Projekti është prezantuar para publikut së bashku me propozime të tjera për parqe solare. Komisioni Komunal ka miratuar disa nga projektet (përfshirë edhe këtë Projekt), duke konfirmuar se projektet solare mund të realizohen brenda zonave të përcaktuara si më të përshtatshme për zhvillime të tilla, duke përjashtuar njëkohësisht të gjitha tokat bujqësore të kategorive 1–4. Gjatë periudhës së konsultimit prej 30 ditësh, nuk janë pranuar komente specifike në lidhje me këtë Projekt.

6 ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Angazhimi i palëve të interesit është realizuar si pjesë e vlerësimit mjedisor dhe social, duke përfshirë përgatitjen e këtij PAPI, gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2025 dhe janar 2026. Aktivitetet e angazhimit kanë përfshirë takime me përfaqësues komunalë dhe udhëheqës të komuniteteve lokale, anketa në nivel të ekonomive familjare në vendbanimet përreth dhe intervista të synuara me shfrytëzues jo-formalë të tokës.

Angazhimi me udhëheqësit e komunitetit dhe banorët lokalë Janë zhvilluar konsultime me dy kryetarë fshatrash (Veriq dhe Kërrninë) dhe me një anëtar të Kuvendit Komunal (Komuna e Istogut), me qëllim të kuptimit të nivelit të njohurive mbi Projektin në nivel lokal, perceptimeve brenda komuniteteve, trendeve demografike, infrastrukturës dhe shërbimeve kryesore, si dhe cenueshmërive të mundshme të banorëve. Gjithashtu është mbajtur një takim me drejtorin e Drejtorisë Komunale për Planifikim Urban, për të diskutuar pritjet e komunës lidhur me implementimin e Projektit dhe për të marrë çdo informacion të disponueshëm mbi qëndrimet e komunitetit ndaj Projektit. Përveç kësaj, janë realizuar dhjetë anketa në nivel të ekonomive familjare me banorë në vendbanimet Veriq, Tuçep dhe Veriq i Ri, për të diskutuar mbi njohuritë rreth Projektit, kushtet lokale, perceptimet dhe qëndrimet, si dhe përfitimet e mundshme për komunitetin.

Këto konsultime treguan se vendbanimet po përballen me largimin afatgjatë të popullsisë më të re, ndërsa një numër shtëpish aktualisht janë të pabanuara; popullsia e mbetur përbëhet kryesisht nga banorë të moshës më të shtyrë. Bujqësia dhe punësimi në sektorin publik u identifikuan si burimet kryesore të mjeteve të jetesës, të plotësuara në disa ekonomi familjare nga të ardhurat nga punësimi jashtë vendit dhe nga bizneset private. Për sa i përket shërbimeve dhe infrastrukturës, ekonomitë familjare kanë qasje në energji elektrike dhe ujësjellës, përfshirë edhe pusët në disa lokalitete, ndërsa ujërat e zeza zakonisht menaxhohen individualisht, për shkak të mungesës së një rrjeti publik të kanalizimit. Rrugët lokale përgjithësisht janë përshkruar si në gjendje të mirë dhe të përdorshme gjatë gjithë vitit. Banorët i qasen shërbimeve kryesore, si shëndetësia dhe arsimit, kryesisht në Istog, Rakosh, Gurakoc dhe Pejë. Gjatë këtyre konsultimeve nuk janë regjistruar shqetësime apo ankesa formale. Në përgjithësi, të gjitha ekonomitë familjare e konsideruan Projektin si një zhvillim pozitiv, kryesisht për shkak të mundësisë së krijimit të vendeve të punës, veçanërisht për anëtarët më të rinj të familjes. Ekonomitë familjare gjithashtu kanë deklaruar se nuk janë në dijeni për ndonjë element të komunitetit në afërsi që mund të ndikohet (p.sh. shtigje, zona kullote, fusha ose puse) në lidhje me lokalitetet që ata përdorin.

Masat e planifikuara zbutëse që lidhen me shëndetin dhe sigurinë e komunitetit janë përmbledhur në Përmbledhjen jo-teknike.

Angazhimi me shfrytëzuesit jo-formalë të tokës. Janë zhvilluar gjithashtu intervista të synuara me shfrytëzues të identifikuar të tokës së Projektit për të kuptuar praktikën e përdorimit të tokës, kohëzgjatjen e përdorimit, çdo pretendim ndaj tokës, investimet e bëra, rrethanat e ekonomisë familjare, nivelin e informacionit të marrë për Projektin dhe disponueshmërinë e tokës alternative dhe opsioneve të tjera për mjetet e jetesës. Të gjithë përdoruesit e intervistuar raportuan shfrytëzim afatgjatë të pjesëve të tokës së Projektit për prodhimin e kulturave bujqësore. Disa ekonomi familjare kanë theksuar se presin reduktim të pjeshëm të të ardhurave. Megjithatë, të gjitha ekonomitë familjare të intervistuar kanë deklaruar se posedojnë ose kanë qasje në toka të tjera bujqësore, të cilat përdoren në mënyrë aktive për prodhimin e kulturave bujqësore dhe/ose për blegtori dhe prodhim qumështi. Kjo redukton gjasat për ndërprerje të rëndë ose afatgjatë të mjeteve të jetesës dhe mbështet vazhdimësinë e aktiviteteve kryesore bujqësore. Së këndejmi,

asnjë nga ekonomitë familjare të intervistuar nuk pritet të përjetojë zhvendosje të plotë të mjeteve të jetesës. Megjithatë, duke pasur parasysh shfrytëzimin afatgjatë dhe të vazhdueshëm të tokës së prekur nga familjet lokale, humbja e qasjes në tokë do të rezultojë në ndikime të matshme në mjetet e jetesës. Përveç kësaj, është identifikuar një çështje specifike për lokalitetin që lidhet me një strukturë bujqësore joformale (stallë), e cila ndodhet pjesërisht brenda gjurmës së Projektit.

Masat e planifikuara zbutëse që lidhen me shfrytëzimin joformal të tokës dhe ndikimet në mjetet e jetesës janë përmbledhur në Përmbledhjen jo-teknike.

7 PROGRAMI I PLANIFIKUAR PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT

7.1 Inkurajimi i pjesëmarrjes së grupeve të cenueshme

Projekti njeh faktin se disa palë interesi mund të përballen me pengesa që kufizojnë aftësinë e tyre për të pasur qasje në informacion ose për të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet e konsultimit. Këto pengesa mund të lidhen me mobilitet të kufizuar ose aftësi të kufizuara, mjete financiare të kufizuara, moshë të shtyrë, përgjegjësi për kujdes familjar, mungesë të qasjes në mjete digjitale të komunikimit, etj.

Për të mbështetur pjesëmarrjen kuptimplote të këtyre grupeve, Huamarrësi do të zbatojë masa të synuara, si në vijim:

MASA	SI DO TË IMPLEMENTOHET	REFERIMI SEKSIONIN E PAPI	NË
SHPALOSJE E INFORMACIONIT NË MËNYRË TË QASSHME	Dokumentet kryesore të Projektit dhe materialet e konsultimit do të vihen në dispozicion si online, ashtu edhe në kopje fizike, në gjuhën shqipe dhe serbe. Njoftimet për disponueshmërinë e tyre do të publikohen në tabelën e njoftimeve të Komunës dhe në portalin online të lajmeve "Zëri", duke përfshirë udhëzime të qarta se ku mund të gjenden materialet.	Shih kapitullin 7.2 (Shpalosja e dokumenteve të Projektit)	7.2 e të
VEND I PËRSHTATSHËM DHE I QASSHËM PËR TAKIMET PUBLIKE	Takimi konsultues do të mbahet në një lokacion lokal që është lehtësisht i arritshëm për komunitetet e prekura.	Shih kapitullin 7.3 (Konsultimet planifikuara)	7.3 e
FORMATE ALTERNATIVE TË KONSULTIMIT	Konsultime në grupe të vogla ose takime individuale do të organizohen sipas nevojës për ekonomitë familjare të cenueshme, për të ofruar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për shprehjen e shqetësimeve. Kur është e përshtatshme, këto konsultime mund të realizohen edhe përmes telefonit ose në një format tjetër të përshtatshëm për palën e interesit.		
INFORMIM PROAKTIV PËRMES KANALEVE LOKALE	Huamarrësi do të bashkëpunojë me udhëheqësit lokalë të fshatrave për shpërndarjen e informacionit.		
ORAR FLEKSIBËL I TAKIMEVE	Orari i takimeve do të përshtatet për të marrë parasysh përgjegjësitë e kujdesit familjar dhe kufizimet kohore të personave të angazhuar në punë bujqësore. Kjo mund të përfshijë organizimin e sesioneve të përsëritura të të njëjtit konsultim në kohë të ndryshme dhe/ose në ditë të ndryshme, si dhe mbajtjen e takimeve jashtë orarit të zakonshëm të punës (p.sh., në mbrëmje ose gjatë fundjavës), për të mundësuar pjesëmarrje më të gjerë.		

7.2 Shpalosja e dokumenteve të Projektit

Huamarrësi do të bashkëpunojë me Komunën e Istogut për të siguruar shpalosjen e dokumenteve në vijim sa më herët që të jetë e mundur gjatë procesit të zhvillimit të Projektit:

- > këtë PAPI dhe Formularin e ankesave lidhur me Projektin ([Shtojca 1](#) e këtij PAPI), dhe
- > Përmbledhjen jo-teknike (PJT) të Projektit.

Dokumentet do të jenë të disponueshme në gjuhën shqipe dhe serbe në formë të shtypur në ambientet e Komunës së Istogut, ndërsa një njoftim për disponueshmërinë e tyre do të publikohet në:

- > tabelën e njoftimeve të Komunës⁵
- > portalin online të lajmeve “Zëri” (i përdorur edhe për konsultimet e mëparshme, pasi në zonë nuk ka gazeta lokale të shtypura).

7.3 Konsultimet e planifikuara

Para fillimit të punëve ndërtimore, do të organizohet një takim i konsultimit publik për t’ia prezantuar Projektin publikut dhe për të ofruar një kuptim të qartë të fushëveprimit dhe objektivave të Projektit, duke përfshirë informacion mbi kohëzgjatjen e pritshme të punëve ndërtimore, mekanizmin e ankesave për Projektin, mundësitë për punësim potencial, si dhe specifika të tjera relevante të Projektit.

Ky takim do të organizohet në një lokacion të qasshëm për komunitetin lokal, siç është restoranti “Kafe N’Pikë” (ku janë mbajtur edhe takime konsultuese të mëparshme), për të mundësuar qasje të lehtë për të gjithë anëtarët e komunitetit, pa kërkuar udhëtime të gjata ose sfida logjistike.

Takimi do të planifikohet duke marrë parasysh përgjegjësitë e kujdesit familjar dhe periudhat sezonale ose kulmore të punëve bujqësore. Kur është e nevojshme, Huamarrësi do të ofrojë më shumë sesione të njëjtit konsultim në kohë të ndryshme dhe/ose në ditë të ndryshme, ose do të organizojë takime jashtë orarit të zakonshëm të punës (p.sh. në mbrëmje ose gjatë fundjavës), për të mundësuar pjesëmarrjen e palëve të interesit që nuk mund të marrin pjesë në takimet gjatë orëve të zakonshme të ditës.

Banorët lokalë do të informohen për datën e saktë, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit të paktën 10 ditë më herët, përmes tabelës së njoftimeve të Komunës dhe portalit online të lajmeve “Zëri”. Përveç kësaj, udhëheqësit e fshatrave në zonë (Veriq, Tuçep dhe Veriq i Ri) do të njoftohen drejtpërdrejt për shpalljen dhe do t’u kërkohej që ta shpërndajnë më tej informacionin brenda komuniteteve të tyre (p.sh. përmes tabelave të njoftimeve lokale dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me ekonomitë familjare), me vëmendje të veçantë që informacioni të arrijë banorët e moshuar, personat me mobilitet të kufizuar ose me aftësi të kufizuara, si dhe palët e tjera të interesit që janë të cenueshme, të cilat mund të mos kenë qasje të rregullt në kanalet online.

Konsultime specifike me organizata ose ekonomi familjare individuale mund të organizohen gjithashtu sipas nevojës, për shembull për të diskutuar çështje që lidhen me tokën, çështje që mund të lindin për shkak të afërsisë së shtëpive me lokalitetin e IFV-ve (p.sh. shqetësime ose ndikime të paparashikuara), apo çdo shqetësim tjetër që lidhet me Projektin. **Huamarrësi do të jetë i hapur për të lehtësuar takime të tilla me kërkesë të palëve të interesit ose do t’i iniciojë**

⁵ Në këtë zonë nuk ka qendra të tjera komunitare lokale.

ato kur Projekti identifikon nevojën për këtë (p.sh. në rastin e personave të cënueshëm që mund të mos jenë në gjendje të marrin pjesë në takimet publike për shkak të mobilitetit të kufizuar, aftësisë së kufizuar etj.), dhe do të bëjë përpjekje të arsyeshme që ato të organizohen në kohë dhe format të përshtatshëm për palët e prekura. Kur është e përshtatshme, këto konsultime mund të realizohen edhe përmes telefonit ose në një format tjetër të përshtatshëm për palën e interesit.

Të gjitha konsultimet do të regjistrohen në Regjistrin e angazhimit të palëve të interesit ([Shtojca 3](#)).

7.4 Informimi i publikut për punët ndërtimore

Informacioni mbi lokalitetet e ndërtimit, datat e parashikuara të fillimit të punëve, kohëzgjatjen e pritshme të punëve të planifikuara, si dhe çdo ndërprerje të mundshme të qarkullimit rrugor dhe çdo shqetësim tjetër të mundshëm për komunitetin, do të publikohet të paktën 30 ditë para fillimit të punëve, përmes tabelës së njoftimeve të Komunës dhe portalit online të lajmeve “Zëri”.

Pas fillimit të punëve të ndërtimit, SolarApex do të vendosë tabela informative në lokalitetin e ndërtimit për të paraqitur qartë informacionin e kontaktit për shqetësime ose ankesa nga palët e treta. Shënim: Masat për parandalimin dhe kontrollin e ndikimeve nga pluhuri, zhurma dhe trafiku (përfshirë ato që lidhen me receptorët e ndjeshëm dhe grupet e cënueshme) janë përcaktuar në Planin e menaxhimit mjedisor dhe social të Projektit, i cili do të implementohet nga Kontraktori dhe do të mbikëqyret nga Huamarrësi. Një përmbledhje e këtyre masave paraqitet në Përmbledhjen jotechnike të Projektit, e cila publikohet së bashku me këtë PAPI.

7.5 Konsultimet gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Shtëpitë që ndodhen në një distancë rreth 10 m nga lokaliteti i IFV-së (Veriq i Ri) do të vizitohen brenda 3-6 muajve të parë pas vënies në operim, për të verifikuar nëse po shfaqet ndonjë shqetësim i paparashikuar. Bazuar në reagimet e marra, do të vlerësohet nevoja për masa shtesë zbutëse, të cilat do të implementohen me përshtatje të arsyeshme në konsultim me banorët e prekur.

Përveç kësaj, gjatë kësaj faze do të zhvillohen takime të drejtpërdrejta me ekonomitë familjare që mund të ndikohen nga reflektimi dhe shkëlqimi i dritës (dukuria e njohur si “glint and glare”) nga modulet fotovoltaike, për të verifikuar mungesën e këtyre efekteve gjatë operimit të IFV-ve ose për të diskutuar masat përkatëse. Kjo përfshin pesë prona në terren të ngritur rreth 750 m në jug-lindje të IFV Tuçep, në fshatin Kerrninë, të cilat kanë pamje të drejtpërdrejtë të moduleve fotovoltaike; si dhe dhjetë prona në Veriq i Ri, në distancë të afërt (deri në 150 m në perëndim) nga IFV Veriq, ku ndikimi i mundshëm nga reflektimi dhe shkëlqimi i dritës nuk mund të përjashtohet. Këto ekonomi familjare do të vizitohen brenda 3 muajve nga vënia në operim e IFV-ve.

Shënim: Mekanizmi i ankesave lidhur me Projektin (shih kapitullin 8) do të jetë në dispozicion gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit, për të siguruar paraqitjen e shqetësimeve dhe ankesave në çdo kohë, ndërsa informacioni i kontaktit do të përditësohet sipas nevojës. Të gjitha ankesat do të regjistrohen dhe pranohen zyrtarisht, pastaj ato do të vlerësohen dhe trajtohen brenda afateve të përcaktuara dhe ankuesit do të informohen për rezultatin dhe për çdo masë korrigjuese të ndërmarrë. Regjistrat e ankesave dhe përgjigjeve do të ruhen, ndërsa çështjet e përsëritura do të përdoren për të informuar menaxhimin adaptiv dhe, kur është e nevojshme, për të përditësuar masat zbutëse dhe praktikatat e menaxhimit në lokalitet.

7.6 Objektivat dhe metodat e angazhimit

Lista e palëve të interesit të identifikuara dhe kërkesat specifike për komunikim paraqiten në tabelën më poshtë, të kategorizuara si: palë interesi primare (të prekura drejtpërdrejt) dhe palë interesi sekondare (me ndikim dhe/ose të prekura në mënyrë të tërthortë). Për qëllimet e kësaj tabele, palët e interesit janë gjithashtu të grupuara sipas llojit: palë interesi të brendshme (personeli i përfshirë në implementimin e Projektit) dhe palë interesi të jashtme (palë jashtë organizimit të Projektit).



Tabela 7-1: Lista e palëve të interesit të identifikuara dhe metodat specifike të komunikimit dhe angazhimit

KATEGORIA E PALËS SË INTERESIT	LLOJI I PALËS SË INTERESIT	PALËT E INTERESIT TË IDENTIFIKUARA	ÇËSHTJET OSE INTERESAT SPECIFIKE	METODAT E KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT ME AFATET PËRKATËSE	INFORMACIONI QË DO TË SHPALOSET
Primare	Të jashtme	<p>Komunitetet lokale dhe bizneset që mund të ndikohen nga ndërtimi dhe operimi i IFV-ve</p> <p>Përfshin gjithashtu grupe të ndjeshme si fëmijët dhe të moshuarit, të cilët mund të jenë veçanërisht të cenueshëm ndaj ndikimeve nga pluhuri, zhurma dhe rritja e trafikut gjatë ndërtimit, si dhe personat me mobilitet të kufizuar, me aftësi të kufizuara ose me qasje të kufizuara në kanalet kryesore të komunikimit të Projektit (p.sh. transport i kufizuar, qasje e kufizuar në internet ose pengesa në shkrim–lexim).</p> <p><i>Shih pikën e veçantë më poshtë për detaje lidhur me receptorët e mundshëm të efekteve “glint dhe glare” (reflektimi dhe shkëlqimi i dritës nga modulet fotovoltaike).</i></p>	<p>Shqetësime që lidhen me ndërtimin (pluhuri, zhurma, siguria në trafik, shmangia e dëmtimit të rrugëve lokale, etj.).</p> <p>Interes për mundësi punësimi.</p>	<p>Faza e para-ndërtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Qasje në PAPI dhe PJT të Projektit si online ashtu edhe në formë të shtypur. > Takim publik para fillimit të ndërtimit; njoftim për konsultimet publike 10 ditë më herët. > Konsultime në grupe të vogla ose individuale sipas nevojës për ekonomitë familjare të cenueshme, përfshirë përmes telefonit ose në një format tjetër të përshtatshëm për palët e interesit; bashkëpunim me udhëheqësit e fshatrave për shpërndarjen e informacionit në komunitet. > Shpalosja e informacionit mbi punimet e planifikuara të ndërtimit të paktën 30 ditë para fillimit të punëve. <p>Faza e ndërtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Tabela informative që do të vendosen nga SolarApex në lokalitetin e ndërtimit. <p>Faza e operimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Brenda 3-6 muajve pas vënies në operim të IFV-ve, 	<ul style="list-style-type: none"> > PAPI dhe PJT > Informacion mbi shtrirjen, kohën dhe kohëzgjatjen e punëve të planifikuara > Informacion mbi disponueshmërinë e mekanizmit të ankesave



PËR PËRDORIM ZYRTAR

KATEGORIA E PALËS SË INTERESIT	LLOJI I PALËS SË INTERESIT	PALËT E INTERESIT TË IDENTIFIKUARA	ÇËSHTJET OSE INTERESAT SPECIFIKE	METODAT E KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT ME AFATET PËRKATËSE	INFORMACIONI QË DO TË SHPALOSET
				<p>ekonomitë familjare më të afërta në Veriq i Ri do të vizitohen për të verifikuar nëse po shfaqen ndikime të paparashikuara dhe për të implementuar masa shtesë zbutëse sipas nevojës.</p> <p>Të gjitha fazat e Projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Mekanizmi i ankesave të komunitetit > Ofrimi i përgjigjeve me kohë ndaj pyetjeve dhe ankesave. 	
Primare	Të jashtme	Shfrytëzuesit jo-formalë të tokës	Humbja e qasjes në tokën e kultivuar; ndikime të pjesshme në mjetet e jetesës; orari i ndërtimit dhe kufizimet e qasjes në tokë; masat zbutëse; qasja në mekanizmin e ankesave.	<p>Faza e para-ndërtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Qasje në PAPI dhe PJT të Projektit si online ashtu edhe në formë të shtypur. > Takim konsultimi publik para fillimit të ndërtimit; informacion mbi konsultimet publike 10 ditë më herët. > Njoftim paraprak për kufizimet e qasjes në tokë dhe aktivitetet e punëve ndërtimore <p>Të gjitha fazat e Projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Angazhim në vijimësi, sipas nevojës > Mekanizmi i ankesave të komunitetit 	<ul style="list-style-type: none"> > Fushëveprimi dhe afatet kohore të Projektit; orari i punëve ndërtimore > Rregullimet për qasjen në tokë > Masat zbutëse që lidhen me rivendosjen e mjeteve të jetesës > Mundësitë e punësimit > Mekanizmi i ankesave që lidhen me Projektin



PËR PËRDORIM ZYRTAR

KATEGORIA E PALËS SË INTERESIT	LLOJI I PALËS SË INTERESIT	PALËT E INTERESIT TË IDENTIFIKUARA	ÇËSHTJET OSE INTERESAT SPECIFIKE	METODAT E KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT ME AFATET PËRKATËSE	INFORMACIONI QË DO TË SHPALOSET
Primare	Të jashtme	Banorët që mund të ndikohen nga reflektimi dhe shkëlqimi i dritës (dukuria e njohur si “glint and glare”) nga modulet fotovoltaike	<p>Reflektimi dhe shkëlqimi i dritës (dukuria e njohur si “glint and glare”) nga modulet fotovoltaike gjatë operimit të IFV-ve</p> <p>Masat zbutëse që do të implementohen në konsultim me banorët e prekur</p>	<p>Faza e para-ndërtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Qasje në PAPI dhe PJT të Projektit si online ashtu edhe në formë të shtypur. <p>Faza e operimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Takime të drejtpërdrejta me banorët e prekur për të verifikuar mungesën e reflektimit dhe shkëlqimit të dritës (dukuria e njohur si “glint and glare”) nga modulet fotovoltaike gjatë operimit të IFV-ve ose për të diskutuar masat përkatëse – ekonomitë familjare do të vizitohen brenda 3 muajve nga vënia në operim e IFV-ve. > Mekanizmi i ankesave të komunitetit 	<ul style="list-style-type: none"> > Informacion mbi reflektimin e mundshëm të dritës diellore, duke përfshirë kohën dhe kohëzgjatjen e mundshme të efektit gjatë fazës së operimit. > Informacion mbi procedurën për menaxhimin e reflektimit dhe shkëlqimit të dritës (dukuria e njohur si “glint and glare”) nga modulet fotovoltaike, që do të zhvillohet dhe implementohet për trajtimin e ankesave nga banorët e prekur. Procedura do të përcaktojë mënyrën e verifikimit të reflektimit të dritës diellore dhe masat zbutëse që do të ndërmerren.
I mesëm	Të jashtme	Palët me interes të përgjithshëm në energjinë e ripërtëritshme dhe/ose projektet e energjisë diellore	<p>Suksesi i përgjithshëm i Projektit dhe përputhshmëria me standardet ndërkombëtare.</p> <p>Interes për implementimin e Projektit dhe për çdo çështje që lidhet me aspektet mjedisore.</p>	<p>Faza e para-ndërtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Qasje në PAPI dhe PJT > Takim konsultimi publik <p>Të gjitha fazat e Projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> > Angazhim në vijimësi, sipas nevojës 	<ul style="list-style-type: none"> > PAPI dhe PJT > Informacion mbi shtrirjen, kohën dhe kohëzgjatjen e punëve të planifikuara



PËR PËRDORIM ZYRTAR

KATEGORIA E PALËS SË INTERESIT	LLOJI I PALËS SË INTERESIT	PALËT E INTERESIT TË IDENTIFIKUARA	ÇËSHTJET OSE INTERESAT SPECIFIKE	METODAT E KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT ME AFATET PËRKATËSE	INFORMACIONI QË DO TË SHPALOSET
I mesëm	Të jashtme	Autoritetet dhe organizatat relevante qeveritare	Lëshimi i lejeve, pëlqimeve dhe opinioneve në përputhje me legjislacionin kombëtar; monitorimi i përputhshmërisë.	Faza e para-ndërtimit dhe faza e ndërtimit: <ul style="list-style-type: none"> > Kanale zyrtare komunikimi. > Konsultime me autoritetet qeveritare në kuadër të procedurave të pajisjes me leje. Faza e operimit: <ul style="list-style-type: none"> > Raportim dhe monitorim në përputhje me kërkesat e legjislacionit të brendshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> > Informacion mbi aktivitetet e Projektit në formatet dhe sipas kërkesave të legjislacionit të brendshëm.
Primare	Të brendshme	Huamarrësi / Kompanitë e Projektit (ShQP-të) / ekipi i menaxhimit të Projektit	Implementimi i suksesshëm i projektit	Të gjitha fazat e Projektit: <ul style="list-style-type: none"> > Takime të brendshme koordinuese; sesione informative ("toolbox" / "briefing"); kontroll i dokumentacionit. 	<ul style="list-style-type: none"> > Të gjitha kërkesat e Projektit, shabllonet e raportimit dhe protokollet e komunikimit.
Primare	Të brendshme	Punëtorët e SolarApex (Kontraktori)	Shëndeti dhe siguria në punë; kushtet e punës dhe të punësimit.	Faza e para-ndërtimit dhe faza e ndërtimit: <ul style="list-style-type: none"> > Trajnim hyrës para mobilizimit për punëtorët e Kontraktorit dhe nënkontraktorëve. > Takime informative në lokalitetet e ndërtimit mbi shëndetin dhe sigurinë në punë, Procedurën për gjetje të rastësishme, dhe tema të tjera përkatëse. > Mekanizmi i ankesave për punëtorët me procedura të qarta për paraqitje, përgjigje dhe zgjidhje. 	<ul style="list-style-type: none"> > Rregulloret për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. > Standardet e punës, kodi i sjelljes së punëtorëve, mekanizmi i ankesave për punëtorët, si dhe identifikimi, parandalimi dhe raportimi i çdo incidenti të dhunës dhe ngacmimit me bazë gjinore. > Informacion mbi mekanizmin e ankesave për punëtorët



8 MENAXHIMI I ANKESAVE

Pasqyrë

Huamarrësi synon të sigurojë që ndërtimi i IFV-ve të mos rezultojë me ndikime të pafavorshme për personat që jetojnë në afërsi të lokaliteteve të Projektit ose për palë të tjera të interesit që mund të preken. Është ngritur një mekanizëm ankesash në nivel Projektit për komunitetet e prekura, si një proces për marrjen, shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave nga komunitetet e prekura.

Mekanizmi i ankesave do të trajtojë shqetësimet me shpejtësi dhe efektivitet, në mënyrë transparente, pa manipulim, ndërhyrje, detyrim, diskriminim, frikësim ose hakmarrje, dhe do të jetë i qasshëm për të gjitha palët e prekura, pa asnjë kosto për ankuesin.

Ky kapitull përfshin shtojcat mbështetëse si në vijim: Formularin e ankesave lidhur me Projektin ([Shtojca 1](#)) dhe shabllonin e Regjistrimit të ankesave ([Shtojca 2](#)).

Seksionet në vijim të këtij kapitulli shpjegojnë procedurën e ankesave lidhur me Projektin dhe hapat përkatës. Ekzistojnë gjithashtu rregullime specifike për ankesat që lidhen me dhunën dhe ngacimimin me bazë gjinore (DhNBGj).

Për punëtorët është i disponueshëm një mekanizëm i veçantë ankesash.

Paraqitja e ankesave

Çdo shqetësim mund t'i paraqitet personit të kontaktit për PAPI (informacioni i dhënë në [seksionin 1.3 Përgjegjësia për implementimin e këtij Plani të angazhimit](#) të palëve të interesit) verbalisht (personalisht ose përmes telefonit) ose me shkrim, duke plotësuar Formularin e ankesave lidhur me Projektin (përmes dorëzimit personal, postës ose e-mailit), pa asnjë kosto për ankuesin. **Ankesat mund të paraqiten gjithashtu në mënyrë anonime ose edhe pa përdorimin e formularit, nëse palët ankuese preferojnë këtë.**

Pas fillimit të punëve të ndërtimit, Formulari i ankesave lidhur me Projektin mund të dorëzohet gjithashtu drejtpërdrejt te SolarApex ose tek inxhinieri mbikëqyrës, të cilët do të përcjellin çdo ankesë të pranuar te personi i kontaktit për PAPI pa vonesë (brenda 24 orëve) për përpunim të mëtejshëm të ankesës/komentit (pra, regjistrimin, konfirmimin e pranimit dhe përgjigjen ndaj ankesës brenda afateve të përcaktuara më poshtë).

Tabelat informative që do të vendosen në lokalitetin e ndërtimit do të shfaqin qartë informacionin e kontaktit për shqetësimet e palëve të treta (të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për trajtimin e çështjeve ose shqetësimeve të ngritura nga palët e treta – emri, pozita, numri i telefonit dhe adresa e e-mailit).

Regjistrimi dhe konfirmimi i ankesave

Të gjitha ankesat do të regjistrohen në Regjistrin e ankesave ([Shtojca 2](#)) dhe do t'iu caktohet një numër identifikues. Ankesat me shkrim dhe jo-anonime do të konfirmohen brenda 5 ditëve pune. Për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e duhur, çdo ankesë do të regjistrohet në regjistër me informacionin në vijim:

- > **përshkrimin e ankesës, duke përfshirë edhe përcaktimin e llojit apo tematikës së ankesës** – si p.sh.: (i) ankesa që lidhen me reflektimin dhe shkëlqimin e dritës (dukuria e njohur si “glint and glare”) nga modulet fotovoltaike gjatë fazës së operimit; (ii) ankesa që lidhen me dhunën dhe ngacimimin me bazë gjinore; (iii) ankesa që lidhen me zhurmën ose pluhurin gjatë ndërtimit, etj., me qëllim të identifikimit me kohë të

- incidenteve më të shpeshta, konstatimit të trendeve dhe menaxhimit të rreziqeve;
- > të dhëna për profilin e ankuesit (gjinia, mosha, vendndodhja dhe cënueshmëritë, nëse janë të njohura), për të kuptuar se kush preket më shumë dhe ku preket më shumë nga ndikimet potencialisht negative të Projektit (*shënim: ky informacion do të trajtohet si konfidencial*),
- > data e marrjes së ankesës dhe data kur është dërguar konfirmimi i pranimit tek ankuesi,
- > përshkrimi i veprimeve të ndërmarra (hetimi, masa korigjuese, masa parandaluese) dhe
- > data e zgjidhjes dhe mbylljes së ankesës ose ofrimit të përgjigjes për ankuesin, duke përfshirë edhe regjistrimin e nivelit të kënaqshmërisë së ankuesit me zgjidhjen e propozuar (shih formularin për mbylljen e ankesës më poshtë).

Asistenca për palët ankuese

Nëse ankesa është e paqartë ose e përgjithshme, palës ankuese do t'i ofrohet asistencë dhe këshillim për formulimin ose rishkrimin e saj, në mënyrë që ankesa të bëhet më e qartë, me qëllim marrjen e një vendimi të informuar, në interesin më të mirë të personave të prekur nga Projekti dhe duke marrë parasysh hapat e zgjidhjes së preferuar nga pala ankuese.

Zgjidhja e ankesave

Do të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të trajtuar ankesën menjëherë pas konfirmimit të pranimit të saj. Nëse kjo nuk është e mundur, do të identifikohet një masë korigjuese afatgjatë. **Pala ankuese do të njoftohet për masën korigjuese të propozuar dhe për veprimet në vijim brenda 10 ditësh pune nga konfirmimi i pranimit të ankesës.** Do të identifikohen dhe implementohen masa parandaluese, me qëllim parandalimin e përsëritjes së të njëjtës çështje në të ardhmen; këto masa do t'i bëhen të ditura edhe palës ankuese.

Gjatë procesit të informimit të ankuesit për veprimet e propozuara, do të verifikohet niveli i kënaqshmërisë së ankuesit përmes plotësimit të **formularit të mbylljes së ankesës**, i cili do të nënshkruhet nga pala ankuese (nëse ai/ajo pajtohet) dhe nga personi i kontaktit për PAPI, për të vërtetuar se të dyja palët janë ndarë të kënaqura me zgjidhjen e arritur. Do të bëhen përpjekje të arsyeshme për të kontaktuar ankuesin edhe pas zgjidhjes së çështjes, për të verifikuar implementimin e suksesshëm të masave të ndërmarra.

Në rast se çështja e ngritur nuk mund të trajtohet përmes mekanizmit të ankesave, ose nëse nuk ka nevojë për veprim, palës ankuese do t'i ofrohet një shpjegim i detajuar dhe arsyetim përkatës për arsyet pse çështja nuk është trajtuar. Përgjigjja gjithashtu do të përmbajë shpjegimin se si personi/organizata që ngriti ankesën mund të vijojë me procesin e ankesës në rast se rezultati nuk është i kënaqshëm.

Në çdo kohë, palët ankuese mund të kërkojnë edhe mjete të tjera juridike, në përputhje me kuadrin ligjor të Kosovës, përfshirë edhe mjetet formale të ankimit gjyqësor.

Rregullime specifike për ankesat që lidhen me DhNBGj

Ankesat që lidhen me DhNBGj (përfshirë shfrytëzimin dhe abuzimin seksual, ngacmimin seksual, si dhe forma të tjera të ngacmimit ose dhunës) do të trajtohen përmes një **procesi veçanërisht të sigurt dhe konfidencial**, duke aplikuar një qasje të përqendruar te pala e dëmtuar dhe duke garantuar respekt, mosdiskriminim dhe mbrojtje nga hakmarrja. Të gjitha ankesat e tjera në kuadrin të mekanizmit të ankesave të Projektit trajtohen gjithashtu në mënyrë konfidenciale dhe pa

hakmarrje; megjithatë, ankesat që lidhen me DhNBGj i nënshtrohen masave shtesë mbrojtëse për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme.

Ankesat për DhNBGj mund të paraqiten përmes kanaleve standarde të Projektit; megjithatë, **ankuesit mund t'i raportojnë ato edhe drejtpërdrejt te Pika Fokale për DhNBGj, i cili do të jetë specialisti për çështje Mjedisore dhe Sociale pranë Projektit, që do të emërohet para fillimit të ndërtimit.** Pika Fokale për DhNBGj do të jetë një specialist i kualifikuar për çështje Mjedisore dhe Sociale, me përvojë dhe/ose trajnim për trajtim konfidencial të ankesave për DhNBGj dhe qasje të përqendruar te pala e dëmtuar, si dhe për mekanizmat e referimit të shërbimet përkatëse.

Emri dhe të dhënat e kontaktit të Pikës Fokale për DhNBGj do të paraqiten në tabelat informative në lokalitetin e ndërtimit. Ankesat mund të paraqiten verbalisht ose me shkrim, përfshirë edhe në mënyrë anonime. Ankuesit nuk do të detyrohen të përdorin formularin standard të ankesës dhe nuk do t'u kërkohet të ofrojnë informacion të detajuar ose prova.

Nëse një ankesë për DhNBGj pranohet nga personi i kontaktit për ankesa të përgjithshme ose nga ndonjë përfaqësues tjetër i Projektit, ajo do t'i përcillet menjëherë Pikës Fokale për DhNBGj (brenda 24 orëve) për trajtim të mëtejshëm. Personi që merr një ankesë të tillë është i detyruar të respektojë parimet dhe rregullimet e përcaktuara në këtë seksion, pa ndarë asnjë informacion përtej atij që është rreptësisht i nevojshëm. Po ashtu, nëse Pika Fokale për DhNBGj pranon një ankesë që nuk lidhet me DhNBGj, ajo do të regjistrohet dhe trajtohet përmes mekanizmit standard të ankesave nga personi i kontaktit për ankesa të përgjithshme.

Qasja në ankesat për DhNBGj do të kufizohet rreptësisht në një grup shumë të vogël personash mbi bazën e parimit "nevoja për të ditur", të udhëhequr nga Pika Fokale për DhNBGj. **Ankesat për DhNBGj nuk do të regjistrohen në Regjistrin e Ankesave të përgjithshme me të dhëna personale.** Në vend të kësaj, ato do të regjistrohen duke përdorur vetëm informacion jo-identifikues. Të gjitha regjistrimet do të ruhen në mënyrë të sigurt.

Pas marrjes së ankesës, **Pika Fokale për DhNBGj do të merret vesh me ankuesin për një mënyrë të sigurt komunikimi** (nëse ankesa nuk është anonime), **do të adresojë çdo nevojë të menjëhershme për siguri dhe do të ofrojë referim tek ofrues të kualifikuar të shërbimeve** (mjekësore, psikosociale, ligjore, strehim), bazuar në pëlqimin e palës së dëmtuar. Nëse pretendimi përfshin punëtorë të Projektit, Huamarrësi/ Kontraktori do të aplikojë masat përkatëse sipas Kodit të Sjelljes dhe veprime të tjera të përshtatshme, duke ruajtur konfidencialitetin dhe pa kërkuar që pala e dëmtuar të përballet me personin që pretendohet se ka kryer shkeljen. Rastet e DhNBGj do të raportohen vetëm në formë të agreguar dhe të anonimizuar.

**PROJEKTI KOSOVO SOLAR – TUÇEP DHE VERIQ
Pika Fokale për DhNBGj (specialisti për çështje Mjedisore dhe Sociale) – të dhënat e kontaktit:**

Emri: Nuk dihet ende (do të emërohet para fillimit të ndërtimit)
Telefoni: Nuk dihet ende
E-mail: Nuk dihet ende

Huamarrësi do ta përditësojë këtë PAPI me emrin dhe të dhënat e konfirmuara të kontaktit sapo të emërohet specialisti për çështje Mjedisore dhe Sociale dhe, në çdo rast, para fillimit të punëve ndërtimore. Të dhënat e konfirmuara të kontaktit do të paraqiten gjithashtu në tabelat informative në lokalitetin e ndërtimit.

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektet në kuadër të BERZH

Përveç mekanizmit të ankesave në nivel të Projektit, Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektet (IPAM) e BERZH-it,⁶ përbën një mjet të pavarur dhe të fundit për zgjidhjen e ankesave, që përdoret në rastet kur mekanizmi i projektit dështon. Qëllimi i këtij mekanizmi është: të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve që lidhen me ndikimet sociale, mjedisore dhe transparencën publike, të ngritura nga personat e prekur nga projekti ose nga organizatat e shoqërisë civile, në lidhje me projektet e financuara nga BERZH-i; të vlerësojë nëse Banka ka vepruar në përputhje me PMS-në e saj, si dhe me dispozitat specifike për Projektin të përfshira në Politikën për Qasje në Informacion; dhe, kur është e aplikueshme, të adresojë çdo mospërputhje ekzistuese me këto politika dhe të ndihmojë në parandalimin e mospërputhjeve të mundshme në të ardhmen nga ana e Bankës.

⁶ Më shumë informacion mbi procesin IPAM mund të gjendet këtu: <https://www.ebrd.com/what-we-do/independent-project-accountability-mechanism.html>



9 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Rezultatet e procesit të angazhimit të palëve të interesit do të përfshihen në **Raportet Mjedisore dhe Sociale drejtuar BERZH-it**, të cilat do të përgatiten nga Huamarrësi, duke përmbledhur ndikimet mjedisore dhe sociale, performancën në fushën e shëndetit dhe sigurisë, performancën e shpalosjes së informacionit dhe konsultimeve, si dhe implementimin e mekanizmit të jashtëm të ankesave.

Raportet do të përfshijnë, në veçanti, informacionin në vijim:

- > **Numrin dhe llojet apo tematikën e ankesave të komunitetit** të pranuar gjatë periudhës së raportimit (si p.sh.: (i) ankesa që lidhen me reflektimin dhe shkëlqimin e dritës (dukuria e njohur si “glint and glare”) nga modulet fotovoltaike gjatë fazës së operimit; (ii) ankesa që lidhen me dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore; (iii) ankesa që lidhen me zhurmën ose pluhurin gjatë ndërtimit, etj., me qëllim të identifikimit me kohë të incidenteve më të shpeshta, konstatimit të trendeve dhe menaxhimit të rreziqeve; duke përfshirë edhe treguesin për ankesat e hapura, të zgjidhura dhe të mbyllura, si dhe nëse ato janë mbyllur brenda afateve të përcaktuara në mekanizmin e ankesave.
- > Numrin dhe llojet e aktiviteteve të shpalosjes së informacionit të realizuara përmes të gjitha kanaleve.
- > **Vendin dhe kohën e takimeve të zhvilluara për konsultime dhe të aktiviteteve të tjera të angazhimit**, duke përfshirë informacion mbi numrin e pjesëmarrësve, çështjet dhe shqetësimet e ngritura gjatë takimeve, si dhe mënyrën se si këto çështje janë marrë në konsideratë.

Huamarrësi do të jetë përgjegjës për monitorimin e të gjitha aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit që lidhen me Projektin, duke siguruar përmbushjen dhe përditësimin e këtij PAPI, si dhe për raportimin drejtuar BERZH-it dhe publikut.

[Shtojca 3](#) e këtij PAPI ofron një shabllon për ndjekjen e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit.

10 SHTOJCAT

10.1 Shtojca 1: Formulari i ankesave lidhur me Projektin

Numri i referencës	
Emri dhe mbiemri i plotë (me dëshirë) <ul style="list-style-type: none"> Dëshiroj të paraqes ankesën time në mënyrë anonime. Kërkoj që identiteti im të mos jepet pa pëlqimin tim. 	
Informacioni i kontaktit Ju lutemi shënoni mënyrën si dëshironi t'ju kontaktojmë (postë, telefon, email).	Me postë: Ju lutemi jepni adresën postare: _____ _____ _____ Me telefon: _____ Me e-mail: _____
Gjuha e preferuar e komunikimit	- Shqip - Serbisht - Tjetër _____
Përshkrimi i ankesës/incidentit për të cilin ankoheni	Çfarë ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi? Çfarë është rezultati i problemit?
Data e incidentit/ankesës	
	<ul style="list-style-type: none"> Incident/ankesë që ka ndodhur vetëm një herë (data _____) Incident/ankesë që ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____) Incident/ankesë e vazhdueshme (aktualisht po ballafaqoheni me problemin)
Çfarë do të dëshironit të ndërmerret për të zgjidhur problemin?	

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Ju lutemi ktheni këtë formular te:

z. Arten Bajrush, AKG SOLAR
E-mail: arten.bajrush@akgsolar.com
Telefoni: +383 49 789 907

**Për ankesa lidhur me dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore (DhNBGj), mund të kontaktoni drejtpërdrejt:
 Pika Fokale për DhNBGj (specialisti për çështje Mjedisore dhe Sociale):
 Emri: Nuk dihet ende (do të emërohet para fillimit të ndërtimit)
 Telefoni: Nuk dihet ende
 E-mail: Nuk dihet ende**

10.2 Shtojca 2: Regjistri i ankesave – Shabllon

Shënime:

1. Të dhënat personale do të përpunohen në përputhje me Ligjin e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Për ankesa lidhur me DhNBGj, mos shënoni emrat, të dhënat e kontaktit apo përshkrimet përkatëse në këtë regjistër.

	Emri i ankuesit	Profili i ankuesit	Informacioni i kontaktit	Data e marrjes	Data e konfirmimit	Lloji apo tematika e problemit	Personi apo departamenti përgjegjës	Përshkrimi i ankesës	Zgjidhja e propozuar	Afati për veprim	Rezultatet e ndërhyrjes	Data e mbylljes	Formulari i mbylljes, i nënshkruar (Po/Jo)	Veprimet në vijim të ankesës	Rikthim/Përsëritje e çështjes (Po/Jo)	Masa / shënime
1.	<i>Shkruani emrin ose "anonim"</i>	<i>Gjinia, moshë, vendbanimi dhe cenueshmëritë përkatëse, nëse dihen</i>				<i>P.sh., reflektim i dritës diellore (efekt "glint and glare"), zhurmë, pluhur, dhunë dhe ngacmim me bazë gjinore</i>										
2.																
3.																
4.																
5.																

10.3 Shtojca 3: Regjistri i brendshëm i angazhimit të palëve të interesit – Shabllon

Shënim: Të dhënat personale do të përpunohen në përputhje me Ligjin e Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale.

	Kategoria dhe emri i palës së interesit	Lloji i angazhimit	Data e angazhimit	Çështjet/shqetësimet kryesore	Dakordësimi i veprimeve/masave në vijim	Shënime mbi progresin
1.	<i>(p.sh., banor i prekur, institucion kulturor apo fetar...)</i>	<i>(p.sh., takim zyrtar, prezantim, takim informal...)</i>				
2.						
3.						
4.						
5.						

